



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:038088

Datë: 21.12.2020

Numri i dokumentit: 01359129

P.nr.171/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit B. B nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.335/2020, të datës 06.03.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, mori dhe publikisht me datën 08.12.2020 shpalli ndërsa me datë 21.12.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. B, nga babai J.dhe nëna A., e lindur D., i lindur me datë ....., në Gjilan, ku edhe jeton në rrugën , i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datë 27.02.2020, rreth orës 23:20 minuta në Komuna e Gjilanit, i pandehuri B. B pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që zyrtarët policor gjatë patrullimit kanë ndaluar veturën e markës . me targa ... dhe gjatë kontrollimit te i pandehuri është gjetur në çantë të belit, substanca narkotike e llojit ... në peshë prej 1.4 gram në një qese me ngjyrë të zezë e cila substancë narkotike është konfiskuar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë të rrezikshme narkotike.

## II.

Sepse me datë 28.02.2020, rreth orës 17:50 minuta në Gjilan, në rrugën ., i pandehuri B. B pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit të shtëpisë së tij me urdhër të gjykatës tek i njejtë është gjetur substanca narkotike e llojit në peshë prej 1.7 gram e cila sasi i është konfiskuar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë të rrezikshme narkotike.

-Me çka në vazhdimësi ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës,

andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin B. B:

### E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindpesëdhjetë) ditëve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga i pandehuri **KONFISKOHET** substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë të përgjithshme prej 3.1 gram si dhe mulliri për bluarjen e marihuanës të cilat pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohen nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumë prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

REFUZOHET propozimi i prokurorit të shtetit për KONFISKIMIN e të hollave të cilat i janë gjetur të pandehurit me rastin e bastisjes së shtëpisë së tij dhe atë :

- **1 x 100** euro me numër serik ...,
- **1 x 50** euro me numër serik ...
- **7 x 20** euro me numër serik ..., ..., ..., ..., ..., ..., ...,
- **6 x 5** euro me numra serik ..., ..., ..., ..., ... dhe ...,
- **2 x 2** euro të metalta,
- **1 x 1** euro të metalta,
- **16 x 0.50** cent,
- **6 x 0.20** cent,
- **4 x 0.10** cent
- **2 x 0.05** cent.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.03.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.335/2020, kundër të pandehurit B. B nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

Më datë 08.12.2020, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Shefik Mehmeti dhe i pandehuri B. B, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri i lartcekur si dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit ... i datës 27.02.2020, shënimi zyrtar i datës 28.02.2020, raporti njoftues i DHNT i datës 28.02.2020, deklaratat e dëshmitarëve, deklarata e të pandehurit, raporti mbi automjetin e tërhequr, dy memorandume zyrtare-njoftime lidhur me

bastisjen dhe kontrollin e shtëpisë, 6 fotografi të vendit të ngjarjes, procesverbal mbi bastisjen e banesës dhe personave, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve e datës 28.02.2020, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara, shkresa e MPB e datës 27.02.2020, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 27.02.2020, informacionet e personit mbi të kaluarën kriminale për të pandehurin, raporti i shpejtë i datës 27.02.2020, procesverbali i të pandehurit B. B i datës 05.03.2020, raporti i oficerit i datës 05.03.2020, vërtetimi mbi pranim dorëzimin e lëndës si dhe shkresat e tjera të lëndës, po ashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri B. B ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindpesëdhjetë) ditëve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: *pranimin e fajësisë* nga ana e tij meqenëse i njejtë përpos në këtë fazë të procedurës penale fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore e ka bërë edhe në fazat e mëhershme të procedurës penale, *pendimin e tij* të cilin gjykata e mori si pendim real meqenëse i pandehuri kishte deklaruar se është penduar shumë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe konsumimin e substancave narkotike, *keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar* për veprën e kryer, faktin se i njejtë i ka *kërkuar falje* për veprimet e tij, *premtimin e tij që në të ardhmen* nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, *moshën e tij të re* ngase sipas shkresave të lëndës shihet se i pandehuri është i moshës relativisht të re, derisa rrethanë rënduese si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës gjykata për të pandehurin mori *dashjen e tij për ta kryer veprën penale* ngase edhe sipas përshkrimit faktik dhe provave të të cilat gjinden në shkresat e lëndës del se i njejtë brenda 2 ditëve ka kryer vepër penale të natyrës së njejtë dhe për kryerjen e tyre ka shprehur një vendosmëri. Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh gjendjen ekonomike të të pandehurit e cila sipas tij është mesatare dhe rrjedhimisht gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar me gjobë të pandehurit por as familjarëve të tij nuk i rrezikohet mirëqenia e tij ekonomike ndërsa sa i përket shqiptimit të dënimit me kusht përveç

tjerash gjykata pati parasysh edhe *qëllimin e dënimit me kusht* i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim (neni 47 i KPP-ës) vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të prokurorit të shtetit si dhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga i pandehuri B. B ka konfiskuar substancën narkotike e llojit në sasi prej 0.9 gram.

Ndërsa sa i përket propozimit për konfiskimin e shumës së të hollave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilat të pandehurit i janë gjetur me rastin e kontrollit të shtëpisë së tij, gjykata konsideroi se propozimi i lartcekur duhet të refuzohet për faktin se propozimi i prokurorit të shtetit në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës për konfiskimin e tyre është i pabazuar ngase ky nen bënë fjalë për konfiskimin automatik të substancës narkotike për të cilën i pandehuri shpallet fajtor mirëpo përkundër kësaj gjykata është përkujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me këtë propozim dhe gjeti se nuk është vërtetuar se parat e lartcekura janë *dobi pasurore, mjeti i kryerjes së veprës penale apo mjet i cili ka mundësuar kryerjen e veprës penale* dhe si rrjedhojë nuk plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e shumës së të hollave të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë të paguajë paushallin gjyqësor 30 € (tridhjetë euro) si dhe në bazë të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 € (tridhjetë euro) , në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.171/20, me datë 21.12.2020

Zyrtare ligjore,

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Eronita Llapashtica

Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.